

Abstrakt

Ky studim ka për qëllim të trajtojë lirinë e shprehjes, duke u fokusuar në aspekte teorike dhe juridike. Si një e drejtë themelore e njohur nga të gjitha sistemet demokratike, liria e shprehjes luan rol kritik në funksionimin e një shoqërie të lirë e të drejtë. Përmes kësaj të drejte, individit i mundësohet të shpreh lirshëm mendimet, idetë dhe besimet e tij pa frikë nga ndërhyrja, censura apo ndëshkimi. Sot, liria e shprehjes, cilësohet si një nga shtyllat kryesore të një sistemi demokratik, për shkak se ndihmon në ruajtjen e pluralizmit politik dhe social, duke promovuar dhe mundësuar shkëmbimin e lirë të ideve dhe informacioneve. Megjithatë, duke qenë një e drejtë që ndikon drejtpërdrejt në funksionimin dhe zhvillimin e demokracisë, liria e shprehjes përballon gjithashtu sfida të shumta, veçanërisht kur bëhet fjalë për balancimin e saj me të drejtat e tjera dhe interesat e mbrojtura ligjërisht.

Nga aspekti - vështrimi teorik, ky studim eksploron konceptet kryesore që mbështesin lirinë e shprehjes, përfshirë teoritë liberale, të cilat synojnë minimizimin e ndërhyrjeve të shtetit në të drejtën e individëve për të shprehur mendimet e tyre, duke mos e zbehur edhe rëndësinë që ka për teoritë për demokracinë dhe pluralizimin e mendimeve dhe informimit, të cilat janë qenësore në zhvillimin e debatit të hapur dhe të larmishëm me qëllim progresin e shoqërisë. Në kuadër të aspekteve teorike do të trajtohen mendime të mendimtarëve - filozofëve të ndryshëm të cilët kanë lënë gjurmë për sa i përket lirisë së shprehjes si Immanuel Kant, John Stuart Mill, John Locke, Volteri e të tjerë, të cilët kanë kontribuar në formësimin e kuptimit modern të lirisë së shprehjes. Përmes analizës së thelluar, studimi ndjek evoluimin historik të kësaj të drejte.

Aspekti juridik i studimit përqendrohet në kornizën ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare të cilat kanë përcaktuar mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Në këtë kontest, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) paraqiten si mekanizma primarë për mbrojtjen e kësaj të drejte. GjEDNj-ja, ka luajtur rol të rëndësishëm në përcaktimin e kufijve të lirisë së shprehjes, duke theksuar se kjo e drejtë nuk është absolute, por mund të kufizohet ligjërisht në rrethana të caktuara për mbrojtjen e të drejtave të tjera si e drejta për privatësi ose siguria kombëtare. Studimi, gjithashtu fokusohet në analizimin e dispozitave kushtetuese të Republikës së Kosovës, e cila garanton lirinë e shprehjes përmes Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse.

Qasje tjetër është edhe ajo e studimit të qëndrimeve që ka mbajtur GjEDNj-ja, ndaj çështjeve të ndryshme të cilat ndërlidhen me lirinë e shprehjes në raport me të drejtat e tjera me theks të veçantë të drejtën e privatësisë, pastaj me censurën, kufizimet dhe çështje të tjera. Gjithashtu, do të ofrohen të dhëna të cilat flasim për balancimin në mes të lirisë së shprehjes dhe të drejtës për privatësi. Censura, presioni i jashtëm mbi mediat dhe disa nga sfidat me të cilat përballen mediat dhe gazetarët do të jenë pjesë e studimit.

***Fjalët kyçe:** Liria e shprehjes, liria e mendimit, e drejta për informacione, censura, etj.*